



Pranuar / Dorezuar Prilimeno/Prodato Received/Delivery	26.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTOCK	6476/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.806/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca – kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.806/2022 të datës 20.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit Nr.138/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Shqyrtimit të Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën e mbajtur më datën 25.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.806/2022 të datës 20.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, me datë 20.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5506/2022 të regjistruar me shenjen A.nr.806/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit Nr. 138/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me të cilin vendim nëpunësi civil i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në procesin e risistemimit të stafit për shkak të organizimit të brendshëm është transferuar në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 28.09.2022, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për

Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa me datë 24.10.2022 me numër protokollit 6406/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën ankesë me numër protokollit 5506/2022 të regjistruar me shenjen A.nr.806/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me Nr.138/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme; E-mail nga F.T për N.B të datës 26.05.2022; E-mail nga N.B për F.T të datës 26.05.2022; E-mail nga N.B për F.T të datës 26.05.2022; E-mail nga H.S për N.B të datës 26.05.2022; E-mail nga N.B për H.S të datës 26.05.2022; E-mail nga SH.L për N.B të datës 26.05.2022; E-mail nga SH.L për N.B të datës 24.05.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 5724/2022 të datës 28.09.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 6406/2022 të datës 24.10.2022; E-mail nga A.F për C.Z të datës 24.10.2022; E-mail nga C.Z për SH.L të datës 20.10.2022; Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 5906/2022 të datës 05.10.2022; E-mailin nga C.Z për SH.L të datës 20.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit, **është bërë i pamundur**, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë administrimit të provave të lëndës ka konstatuar se vendimi i kontestuar me ankesë, respektivisht Vendimi me numër Nr.138/2022 i datës 15.09.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të cilin vendim nëpunësi civil i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në procesin e risistemimit të stafit për shkak të organizimit të brendshëm është transferuar në pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë, është shfuqizuar me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, duke marr parasysh se pretendimi ankimor i ankuesit ishte pikërisht shfuqizimi i Vendimit Nr.138/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në konstatimin se ky vendim i kontestuar është shfuqizuar paraprakisht në një proces tjetër ankimor nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstatoi se objekti i shqyrtimit të ankesës së ankuesit është bërë i pamundur apo i kotë, në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.*


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lëndës dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.806/2022.

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik – MPB; dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së.

